



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Prot. 3018 / Nr. 12

Durrës, më 23 / 12 / 2025

VENDIM

Nr. 11, datë 23 . 12 2025

PËR
"SHPALLJEN E DATAVE PËR PROCESIN E REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE
PËR ANËTARË TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS
SHKENCORE "DOKTOR", NË FAKULTETIN E SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE,
TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Në mbështetje të ligjit Nr.80/2015, datë 17/09/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46; të Statutit të UAMD-së, neni 30; të Rregullores së UAMD-së, neni 19; të nenit 23,24,25 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", miratuar me vendim Senati Akademik nr.29, datë 29.03.2024; të Urdhrit të Rektorit nr.580, datë 03.12.2025 "Për shpalljen e zgjedhjeve për anëtar të Komisionit të Përhershëm të Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor", pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës"; Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.12.2025,

VENDOSI:

1. Procesi i regjistrimit të kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, do të zhvillohet nga data **05.01.2026** deri në datën **09.01.2026** pranë sekretarisë së KZF-së, Fakulteti Shkencave Politike Juridike.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve do të jetë **19.01.2026**.
3. Bashkëlidhur vendimit, dokumentacioni dhe formularët të cilët do të dorëzohen për kandidim.
4. Ngarkohet KZF e FSHPJ-së për marrjen e masave për vazhdimin e procedurës përkatëse.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Kriteret bazuar në nenin 19 të Rregullores së UAMD-së dhe Dokumentacioni për kandidim:

1. Anëtarët e Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës shkencore "Doktor" në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore (FSHPJ) për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Anëtarët mbajnë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar".
Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë së KZF Fakultetit të Shkencave Politike Juridike dokumentacionin si mëposhtë:
 - a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemër; datëlindjen; gjininë; titullin akademik që zotëron;
 - b) formulari i vetëdeklarimit bashkëlidhur Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës" e miratuar me vendim Senati Akademik nr.29, datë 29.03.2024, për :
 - mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore doktor dhe titullit akademik;
 - garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas ligjit 138/2015,
3. Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
4. Kopje të dokumentit të identifikimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

KOMISINI I ZGJEDHJEVE FAKULTETI SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE

KËRKESË PËR KANDIDIM

PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS

SHKENCORE "DOKTOR" NË FAKULTETIN E SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE

Unë i/e nënshkruari/a (emër, atësi, mbiemër) _____, lindur më
____/____/____, në _____, gjinia _____, me nr. personal të dokumentit të identifikimit
_____, me titull _____ që unë zotëroj, paraqes kërkesën time për të kandiduar për
anëtar të Komisionit të Përherëshëm për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor", në Fakultetin e Shkencave
Politike Juridike në zgjedhjet e datës 19.01.2026.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale si më poshtë:

1. Nuk kam qenë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike';
2. Për mungesën e plagjaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
3. Nuk jam dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
4. Ndaj meje nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi.

Kësaj kërkesë i bashkangjitet, kopja e kartës së identitetit/pasaportës, kopja e titullit _____ që unë zotëroj, vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore, formulari bashkëlidhur Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", miratuar me vendim Senati Akademik nr.29, datë 29.03.2024.

Për sa deklaroja në këtë kërkesë mbaj përgjegjësi personale dhe autorizoj Komisionin të bëjë verifikimet që ai konsideron të nevojshme.

Aplikuesi

U dorëzua sot, më datën _____, në zyrën _____, tek sekretaria e KZF, (firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Në zbatim të nenit 20, 21 dhe 24, 25 të Rregullores 'Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, miratuar me vendim nr.29, datë 29.03.2023, kandidat për , deklaroj si më poshtë:

Emër,
Atësi,
Mbiemër,
Datëlindje,

1. Deklaroj se nuk kam qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale; nuk jam në ndjekje penale dhe ndaj meje nuk ka nje masë të sigurimit personal;
2. Deklaroj se nuk kam qenë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike';
3. Deklaroj se nuk kam qenë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 45/2015 'Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;
4. Deklaroj neutralitetin politik dhe angazhimin që të mos zhvilloj në institucion veprimtari në dobi të forcave politike.
5. Deklaroj nën përgjegjësinë time për mungesën e plagjaturës në punimet për fitimin e Gradës/Titullit shkencor.

Emër, Mbiemër, Firmë



FORMULAR VETEDEKLARIMI

Te dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, Emri	
Atësia, Mëmësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (nje kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lire se jam : ☐ i/e padënuar ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRESI I VETEDEKLARIMIT

Emër Mbiemër / Firmë

Emër Mbiemër / Firmë

Autorizim : Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale ne vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517 datë 22. 07. 1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
Deklarimi l rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.